



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.304/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Skender Çoçaj -anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Elton Xhemajli, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 24.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEN TË PABAZUARA ankesat e parashtruara nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Elton Xhemajli, ZL.Anr.304/2025, ZL.Anr.305/2025, ZL.Anr.306/2025, ZL.Anr.307/2025 dhe ZL.Anr.308/2025, të datës 22.10.2025, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 22.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.304/2025, ZL.Anr.305/2025, ZL.Anr.306/2025, ZL.Anr.307/2025 dhe ZL.Anr.308/2025, e parashtruara nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Elton Xhemajli, në të cilat pretendon se në vendvotimet në komunën e Pejës, me numrat 1710, 1710/03, 1710/02, dhe 1730 gjatë procesit të numërimit të votave, ka vërejtur se votat e tij nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë në rezultatet preliminare të publikuara nga KQZ. Ka dyshime për gabim teknik ose neglizhencë në procesin e regjistrimit të rezultateve, prandaj ka kërkuar rinumërimin e qendrave të votimit.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, datë 23.10.2025, theksohet se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese, të kandidatit për Kuvendin e Komunës së Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Elton Xhemajli, KQZ jep sqarimet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Gjithashtu, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Gjithashtu, KQZ pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 22.10.2025, ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Pejës, nga i cili ka marrë përgjigjen si më poshtë: “Më poshtë gjeni bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve në të cilat parashtruesi i ankesës Elton Xhemajli pretendon që i'u është bërë parregullësi gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Pejës. Gjithashtu duhet të ceket që numërimi në QKN është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe pa ndonjë vërejtje”.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese për pasqyrim jo të saktë të rezultateve preliminare, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LJP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.304/2025, ZL.Anr.305/2025, ZL.Anr.306/2025, ZL.Anr.307/2025 dhe ZL.Anr.308/2025, të datës 22.10.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZL.A.nr.304/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pasi shqyrtoi ankesat dhe përgjigjet në ankesa, vëren se:

- Ankesat janë të pabazuara.

Paneli pas shqyrtimit të ankesave dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e kandidati për asamblë komunale në Komunën e Pejës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Elton Xhemajli, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesat nuk është arritur që të vërtetohet fakti me prova konkrete se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesat, *përkatësisht se votat nuk janë pasqyruar në mënyrë të saktë në rezultatet preliminare të publikuara*. Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se parashtruesi i ankesave nuk ka mbështetur pretendimet e tij me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar dëshmi asnjë provë dhe dëshmi të qartë dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LJP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin

dhe në rastin konkret, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave në qendrat e votimit të komunës së Pejës.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së, vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë sepse nuk është pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale nga vëzhguesit e partive politike dhe vëzhguesit ndërkombëtar as në ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe as Formularët e rezultateve të subjekteve politike (FRS) dhe Formularët e rezultateve të kandidatëve (FRK) të ofruara në përgjigje nuk vërehet asnjë shënim apo vërejtje në Librin e Shënime në QKN, në Komunën e Pejës.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesa, ankuesi nuk ka arritur që ti provoj.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.304/2025, datë 24.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.